

ALBANIAN CUSTOMARY LAW AND THE CONTRIBUTION OF EDITH DURHAM, MARGARET HASLUCK AND KAZUHIKO YAMAMOTOS IN ITS STUDY

E DREJTA ZAKONORE SHQIPTARE DHE KONTRIBUTI I EDITH DURHAMIT, MARGARET HASLUCKUT DHE I KAZUHIKO YAMAMOTOS NË STUDIMIN E SAJ

Besim MUHADRI¹

¹* Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Gjakova „Fehmi Agani“

*Corresponding author e-mail: besim.muhadri@uni-gjk.org

Përmbledhje

Qëlimi i këtij punimi është trajtimi i disa aspekteve që kanë të bëjnë me të drejtën zakonore shqiptare “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, të bëra nga Edith Durham, Margaret Hasluck dhe Kazuhiko Yamamoto. Me këtë rast do të vëmë në pah mendimet dhe vlerësimet e këtyre tre studiesve të shquar të antroplogjisë shqiptare. Përpjekjet e studiuesve në studimin e së drejtës zakonore shqiptare, nuk kanë reshtur asnjëherë, mirëpo ato u intensifikuan pas Luftës së Dytë Botërore dhe veçmas në dekadat e fundit të shekullit të kaluar (XX). Në studimet e tyre ata fokusohen në aspekte relevante të kësaj vepre monumentale të etnokulturës shqiptare.

E. Durham është e mendimit se Lekë Dukagjini duhet të ketë qenë një personalitet i fuqishëm i kohës së tij, ndërsa Kanuni i Lekë Dukagjinit, i përngjan me ligjet e fiseve të vendeve të tjera. Ajo hedh dyshimin se ai mund të jetë krijuar më herët sesa në shekullin XV. Margaret Hasluck, të drejtën zakonore shqiptare e sheh si mjet i kuptimit të bazave themelore logjike të këtij kodi si dhe zbatimin e tij në praktikë; K.Yamamoto përqëndrohet tek aspekte etike të Kanunit, gjithnjë në kërkim të gjetjes së elementëve etikë, duke i krahasuar ata me traditat antike japoneze. Analizat kritike të teorive të *Hobbes*, *Rousseau*, *Nietzsche* dhe *Girard*, e shpjen atë te propozimi i një teorie të re, e cila ngulmon në idenë se një shoqëri pa pushtet shtetëror ka etikë dhe rend shoqëror, që zhvillohen në mënyrë të vetvetishme në bazë të besimeve fetare pagane.

Fjalët kyçe: E drejta zakonore, Kanuni, Lekë Dukagjini, Durham, Hasluck, Yamamoto.

1. Hyrje

E drejta zakonore shqiptare apo “Kanuni i Lekë Dukagjinit” është njëra ndër veprat më të rëndësishme jo vetëm e etnokulturës sonë. Dihet se mbledhës dhe kodifikues i këtij dokumenti të së drejtës sonë zakonore, deri atëherë e pashkruar, por vetëm e përfolur dhe e zbatuar me përpikëri në Zonat e Malësisë së Shqipërisë Veriore, Kosovë e më gjerë, është Shtjefën Konstandin Gjeçovi, i cili i mbështetur edhe nga Gjergj Fishta dhe nga etërit e tjerë françeskanë, i kishte hyrë këtij projekti që nga fundi i shekullit XIX, përkatësisht që në fazën e fillimeve të shërbesave të tij si prift. Ndërkaq, punën e tij për kodifikimin e Kanunit të shqiptarëve e intensifikoi në fillim të dekadës së dytë të shekullit XX, përkatësisht në vitin 1913, kur edhe filloi t’i publikonte disa pjesë në revistën *Hylli i Dritës*, e cila sapo kishte filluar rrugëtimin e saj. Megjithatë, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* u botua në vitin 1933. Pra katër vjet pas vdekjes së dhunshme të autorit. Fishta shkroi parathënien e librit, ndërsa shënimet biografike i bëri Pashko Bardhi.

Puna e Gjeçovit në mbledhjen dhe kodifikimin e Kanunit si dhe publikimet e tij, në atë kohë, patën jehonë të madhe që nxitën edhe reagimet e studiuesve të huaj, disa prej të cilëve gjatë hulumtimeve të tyre nëpër viset e Shqipërisë Veriore, në njëfarë mënyre, ishin marrë edhe më parë me Kanunin, qoftë në mbledhjen, qoftë në studimin e disa aspekteve të tij. Mirëpo, studimet për të drejtën zakonore shqiptare, përkatësisht për Kanunin do të intensifikohen veçmas pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në dekadat e fundit të shekullit të kaluar (XX).

Madje, përveç në Evropë, studimet “do të zhvendosen” edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Japoni. Kjo ka bërë që *Kanuni...* të përkthehet në shumë gjuhë të botës, si: italisht, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, serbisht, maqedonisht, norvegjisht etj. Ndonëse lista e atyre që u morën me analizën dhe vlerësimin e Kanunit që nga vitet 20-të të shekullit të kaluar e deri në ditët e sotme është shumë e gjatë, në këtë punim ne do të ndalemi për të parë kontributin e Edith Durhamit, Margaret Hasluckut dhe Kazuhiko Yamamotos.

2. Edith Durhami dhe Ligji i fisit në Shqipërinë Veriore

“Sa herë që pyesja në malësi se përse ishte bërë një çfarëdo, gjithmonë më thoshin “se ashtu e ka thënë Leka”. Ligjet, zakonet, doket, të gjitha i lidhin me Lekën. Duket qartë se ai ka qenë një njeri me personalitet të fuqishëm që ka lënë gjurmë të thella në popull; megjithatë, për të dihen shumë pak gjëra. Kanuni i tij ka kaluar gojë më gojë te pleqtë dhe ata i kanë bërë ndonjë përshtatje sipas krahinave të ndryshme, megjithatë ai ishte në fuqi në tërë malësitë e Shqipërisë Veriore, si për myslimanët ashtu edhe për katolikët. Kur themi ishte “në fuqi”, kjo fjalë duhet të kuptohet me tërë vërtetësinë e saj, sepse shprehja “kështu ka thënë Leka” i bënte njerëzit të bindeshin më tepër sesa *Dhjetë Porositë* dhe, predikimet e hoxhëve dhe priftërinjve, shpesh nuk kishin asnjë vlerë po të binin në kundërshtim me ato të Lekës” (Durham, 2019).

Kështu shkruante Edith Durhami, në fillim të studimit të saj “Ligji i fisit në Shqipërinë Veriore”, që ka të bëjë me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Por, siç shihet në bazë të asaj që ka dëgjuar nga shqiptarët, ajo është e mendimit se Lekë Dukagjini duhet të ketë qenë një personalitet i fuqishëm, gjurmët e të cilit ajo i vëren edhe në fund të shekullit XIX, përkatësisht në fillim të shekullit XX (Durham, 1928). Për të gjetur përgjigjen si dhe për të zgjidhur dilemën se kush ishte Lekë Dukagjini, ky personalitet me ndikim të fuqishëm edhe pas kaq shekujsh, ajo mundohet të përgjigjet, fillimisht duke elaboruar përpjekjet e gjetjes së zanafillës së familjes Dukagjini: “Dukagjinasi ishin krerë të Shqipërisë Veriore dhe ato pak të dhëna për ta na tregojnë se ata sundonin toka të gjera.

Në vitin 1309, mbreti Uroshi II nënshkruante për vete me titullin “Mbret i Serbisë, i Kelmisë, i Dioklesë dhe i Shqipërisë”, kurse pasardhësit e tij e quanin veten “Mbret i Shqipërisë deri me vdekjen e Stefan Dushanit, më 1356; megjithatë, serbët, sado që nxirrnin detyrime në të holla dhe në punë nga krahina të caktuara, prapëseprapë nuk duket se janë futur thellë dhe të kenë shtrirë ndikimin e tyre në malësi. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të marrim parasysh faktin që, me përjashtim të zonës në afërsi të Shkodrës, emrat e vendeve janë shqiptarë dhe se, menjëherë, posa filloi të shpërbëhej Perandoria Serbe me vdekjen e Dushanit, emrat e krerëve shqiptarë shfaqen përsëri. Njoftimi më i vjetër që kam arritur të gjej për Dukagjinin është një letër te Acta et Diplomata Res Albaniae Illustrantia (Nr. 133).

Kjo letër është nga Papa Inocenti III për “fisnikun Demetrius, Princ i Shqipërisë”, në përgjigje të një kërkesë që i bëhej për mësimin e fesë; si dhe një dokument të vitit 1216 që na shpjegon se “Demetriusi është i biri i Progonit dhe vëllai i Gjinit, Kont i Shqipërisë” (Durham, 1928). Durham-i merr si argument edhe një përpjekje kërkimore të Hofit (*Hopf*), i cili siç thotë ajo “si rezultat i shumë kërkimeve, jep një gjenealogji të Dukagjinëve”, ku sipas tij më i hershmi del të jetë “Tanushi I, Dux Ginus, Zot i Zadrimës, i Malit të Zi (Mali i Zi në Drin?), i Pulatit dhe i Shatit”. Sipas Durhamit “ka të ngjarë që ai të jetë Dux Ginius Tanuschus Albanensisi” që u zu rob nga Johannis Scotus-i, Çarli i Kapetanit të Sicilisë, në Durrës, më 1281 (shih *Acta et Diplomata*, Nr.455). “Gini” është fjala shqip për John (shqipto Xhon). Dukagjini është Dukë Johni; këtu “dux” ka kuptimin e prijësit ose të kryetarit. Titulli “duka” rrjedh nga Venediku siç ndodh me “gubernator” dhe “kapedan” në Mal të Zi” (*Hopf*).

Pra, sipas kësaj, po na dilka se “Leka (Aleksandër) I rrjedh nga Tanusius Dux Gins, i cili ishte një prijës që i ndihmoi vendikasin kundër turqve. Pastaj Durhami konsulton një informacion zyrtar nga Lezha që është i dhjetorit të vitit 1387 (*Acta et Dip.* Nr. 413), i cili thoshte se “Vëllezërit Leka dhe Pali i lejojnë raguzianët që të kalojnë lirisht nëpër tokat e tyre”. Ndërkaq, më 1393 (*Acta et Dip.* Nr. 501), zotërinjtë fisnikë, vëllezërit Progoni dhe Tanushi, të bijtë e zotit Lekë Dukagjini të ndjerë, zotër të kështjellës së Lezhës”, në emër të tyre dhe të të afërmeve të tyre, ua dorëzojnë Lezhën vendikasve, meqenëse nuk janë në gjendje ta mbajnë atë kundrejt turqve. Ky Tanushi përshkruhet nga Hopfi si zot i Fandit (tani pjesë e Mirditës).

Meqë ai ishte gjithashtu edhe zot i Lezhës, kjo na tregon se zotërimet e tij ishin të gjera dhe se ai kishte një djalë, Palin, që ishte zot i Gurikuqit, Selitës etj., djali i të cilit, Leka II, ka të ngjarë që të jetë Leka i Kanunit. Sipas Durhamit, që i referohet Hopfit, i cili atë e përshkruan si zot i Danjës dhe i Zadrimës, ndërmjet viteve 1444 dhe 1459, që përkon me ardhjen e turqve, kur Leka luftoi në anën e venedikasve dhe kur ra Shkodra, më 1472, ai dhe shumë të tjerë ikën në Itali bashkë me venedikasin. Por kur vdiq Sulltan Mehmeti, më 1481, dhe të bijtë e tij luftuan midis tyre për të zënë fronin, sundimi turk në Evropë u ndodh në gjendje kritike.

Në njëfarë mënyre, serbët ndihmuan rivendosjen e tij, duke luftuar në anën tjetër nga pretendentët. Në këtë periudhë rrëmuje, Lekë Dukagjini u kthye në vendin e tij, siç bëri gjithashtu edhe Ivan Cernojeviçi, themeluesi i Malit të Zi, i cili u bë vasal i turqve dhe në Mal të Zi është i njohur deri në ditët tona me titullin e tij turk, Ivan Begu. Nuk ka ndonjë të dhënë që Lekë Dukagjini të ketë vepruar në këtë mënyrë. Fakti se ai sundonte në malësi sipas dëshirës së vet, duket nga fama e madhe që gëzonte atje. Thuhet se më 1464 Papa Pali II e kishte shkishëruar atë për kodin e vet që nuk përputhej fare me krishterimin” (*Durham, 1928*).

3. Kanuni i ngjan ligjit të fisit të vendeve të tjera - Leka vetëm modifikues

Durhami gjatë hulumtimit të mëtejshme në lidhje me këtë problematikë, arrin të identifikojë edhe dy pasardhësit e Dukagjinit, të cilët janë bërë myslimanë, disa prej të cilëve u vendosën në Venedik. Njëri ndër ta Luca Ducadini, Duca di Pulato e dell stato Ducagini. Pra shihet se Lekë Dukagjini, Dukë i Pultit dhe i shtetit të Dukagjinit, përmendet në Venedik më 1506. Ajo përmend edhe pretendimet e familjes së Bib Dodës, të cilët siç thotë ajo “deri në Luftën e Madhe ishin kryetarët e trashëguar të Mirditës” dhe që pretendonin se rridhnin nga Dukagjini, mirëpo që “nuk mund të jepnin një gjenealogji të përcaktuar”. Ajo, po ashtu, përmend edhe fisin e Bjelopavliçit në Mal të Zi që nxirrte prejardhjen nga Pali i Bardhë që ishte vëlla ose nip i Lekës” (Durham, 1928).

Megjithëse Leka zbatonte me forcë Kanunin, Durhami është e mendimit se “ai i ngjan kaq shumë ligjit të fisit të vendeve të tjera, saqë ne nuk mund të besojmë që ai ta ketë krijuar atë, në shekullin e pesëmbëdhjetë. Sipas E. Durhamit ajo që Leka “u përpoq të bëjë, në mënyrë të veçantë, ishte ndalimi i krimeve, duke dhënë për to dënime të caktuara. Fakti që ai, sikurse deklaroi gjithmonë malësorët edhe urdhëronte marrjen e gjakut, edhe caktonte dënimin për një veprim të tillë, kjo duket e pabesueshme. Ka të ngjarë që ai ta ketë modifikuar dhe t’i ketë bërë shtesa ligjit që ekzistonte, si dhe ta ketë vënë në zbatim me rëndësi” (Durham, 1928). Sipas Durhamit, ky ishte Kanuni, për aq sa kishte arritur ta njihte.

Më pas ajo përmend Dom Kolë Ashtën, apo siç e quan ajo “prifti shumë i nderuar i Shkrelit”, i cili i kishte dhënë shumë fakte në lidhje me këtë, kurse të tjerat i kishte mësuar nga imzot Mjedja, që në kohën kur bënte këtë shkrim, ai ishte kryepeshkëv i Shkodrës. Po ashtu ajo, përveç ndihmës që i kishin dhënë Kolë Ashta dhe Lazër Mjedja, shumë gjëra kishte arritur t’i mblidhte vetë gjatë udhëtimeve të saj nëpër Malësi. Të dhënat e grumbulluara ajo i kishte krahasuar dhe kishte përpiluar të dhëna specifike që kishin të bënin me Kanunin, ku hynin elemente, si: *vrasja brenda fisit, vrasja jashtë fisit, plagosja, vjedhja, gjoba për çështje të tjera, trashëgimia, çështje të fisit etj.*

Durhami në kohën kur bënte hulumtimet e saj për Kanunin, në Dukagjin ai ishte në formën e tij më primitive, edhe pse qeveria turke kishte arritur ta modifikonte deri diku. Ajo pohon se “Kanuni, gjithkund ishte i lidhur me fisin, i cili (fisi) ushtronte juridiksionin e tij brenda tokave të tij”. Duhet pranuar se përpjekjet e saj edhe në aspektin e hulumtimit dhe të studimit të traditave zakonore shqiptare kanë peshën dhe rëndësinë e vet. Duke qenë një njohëse e mirë e këtyre traditave, por edhe e aspekteve të tjera, ajo arrin në konkludime interesante për Kanunin, por edhe për kodifikuesin e tij, Lekë Dukagjinin.

4. Margaret Haslucku dhe “Ligji i pashkruar i shqiptarëve”

Margaret Hasluck (Margaret Hezllak) (1885-1948), është një studiuese irlandeze, e cila në vitet tridhjetë dhe dyzet të shekullit XX u mor me studimin e etnografisë shqiptare, përkatësisht të së drejtës zakonore shqiptare, Kanunit të Lekë Dukagjinit. Gjatë viteve të qëndrimit të saj në Shqipëri (1926 -1939) ajo udhëtoi vazhdimisht, veçanërisht në zonën malore të veriut shqiptar, ku edhe u lidh shumë me banorët e atyre zonave. Në këto vise ajo arriti të mblidhte shumë të dhëna rreth shqiptarëve, të traditave dhe zakoneve të tyre. Në mënyrë të veçantë ajo ishte interesuar për Kanunin shqiptar, për të cilin ajo kishte mbledhur materiale që përbënin një libër të tërë, të cilin e titulloi “Ligji i pashkruar i shqiptarëve”, me të cilin libër ajo synonte ta kishte historinë e parë të Shqipërisë në gjuhën angleze.

Mirëpo nuk ia arriti dot ta bënte një gjë të tillë, sepse sëmundja e leucemisë e mundi më 17 tetor të vitit 1948, në një kohë kur kishte mbaruar vetëm katër nga njëzet kapitujt si edhe skicën e detajuar të librit të saj që u botua pas vdekjes në vitin 1954, me titullin “Ligji i pashkruar në Shqipëri”. Shkrimin e parathënies dhe redaktimin e librit M. Haslucku ia kishte besuar J. E. Aldersonit, “jo sepse kjo e njihte Shqipërinë apo folklorin, por më tepër si një mike të vjetër që e kishte, duke qenë e bindur se ajo do të bënte gjithçka të mundur për ta bërë librin të gatshëm për botim”, shkruan në mes të tjerash në parathënie Aldersoni. Redaktorja e librit në parathënie jep informacion për gjendjen e dorëshkrimit kur ajo e kishte marrë për ta përgatitur, i cili siç tha edhe në një rast, kishte vetëm katër kapituj të kryer nga 24 që kishte planifikuar autorja.

Libri u përgatit për botim në qershor të vitit 1953, me parathënie të J. E. Aldersonit dhe të Hyrjes nga J. H. Hutoni, në qershor të vitit 1953, ndërsa u botua nga *Cambridge: University Press*, në vitin 1954 me titullin: *Hasluck, Margaret Masson Hardie, “The unwritten law in Albania”*. 1. *Customary law-Albania*. 2. *Albania-Social conditions Cambridge: University Press, 1954*.

Librin “Ligji i pashkruar në Shqipëri” (“The unwritten law in Albania”), Lekë Ndoja e ka përkthyer në shqip me titull “Ligji i pashkruar shqiptar”, duke ia shtuar edhe pjesën “Kanuni Shqiptar”, është një kontribut i veçantë dhe mjaft i rëndësishëm i studiueses irlandeze, Margaret Hasluckut, për ligjet dhe zakonet shqiptare. Libri është konceptuar në njëmbëdhjetë kapituj (nga katër që kishte arritur t’i përfundonte autorja për të gjallë të saj, ndonëse kishte planifikuar 24 kapituj).

“Ligji i pashkruar në Shqipëri” apo “Kanuni Shqiptar” i Margaret Hasluckut përbën një kontribut të rëndësishëm për etnografinë shqiptare të shkruar në gjuhën angleze në pjesën e parë të shekullit XX, i cili për shkak të rrethanave të cekura më lart, u botua me shumë vonesë. I tërë materiali i librit fokusohet rreth së drejtës zakonore të malësisë, të cilat autorja i kishte studiuar mirë për 13 vjet me radhë. Gjatë shtjellimit të materialit, të drejtën zakonore shqiptare Haslucku e sheh si mjet i kuptimit të bazave themelore logjike të këtij kodi si dhe zbatimin e tij në praktikë. Ajo, me mjaft hollësi, arrin të shpjegojë mënyrën e jetesës shqiptare, duke dhënë ndoshta për herë të parë detaje mbi çështje të veçanta, të cilat pasqyrojnë funksionimin e së drejtës së pashkruar të shqiptarëve.

Si njohëse e mirë e jetës dhe e traditave të shqiptarëve të pjesës veriore të Shqipërisë, autorja arrin të na japë informacione interesante mbi përbërjen e familjes shqiptare, mënyrat e saj të jetesës, strukturën e përgjithshme të fshatit dhe të jetës fisnore si dhe mënyrën dhe funksionimin e kuvendeve fisnore. Po ashtu me mjaft imtësi tregohen metodat e trajtimit të krimit kundër pronës apo personit, normat që rregullojnë cenimin e pronës, udhëtimin, madje edhe deri te ushqimi i kopeve, ruajtja e shtëpive nga qentë roje etj. Por, autores, nuk i kanë shpëtuar as aspekte të tjera, ndoshta më esenciale dhe karakteristike, siç janë dhënia e të dhënave të hollësishme mbi trajtimin e besës, mënyrën e vendosjes së dënimeve si dhe normat që rregullojnë gjakmarrjen etj.

Materiali i këtij libri paraqet interes për lexuesin e gjerë, pasi përshkruan jetesën e panjohur ose shumë pak të njohur të një populli me një kulturë të veçantë individuale, por edhe kolektive, “i cili gjatë historisë së tij është veçuar me krenari dhe dëshirë. Pasi shqiptarët, pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve antikë, ende ruajnë forma të lashta të arianishtes në gjuhën e tyre që ndryshon shumë nga degët e tjera të familjes gjuhësore; ata ende ruajnë një sistem të lashtë fisnor dhe ende e duan me zjarr pavarësinë që i detyroi shumë prej tyre t’i braktisnin malësitë e vendit dhe të ngulen në Greqi, Kalabri dhe Sicili, kur pas vdekjes së udhëheqësit të tyre (Gjergj Kastriotit) Skanderbegut më 1467, turqit ua pushtuan atdheun”, shkruan në mes të tjerash J. H. Huton-i në pjesën hyrëse të librit të saj. (*Hasluck, 1954*)

M. Haslucku, duke eksploruar mirë pjesët ku ka qëndruar, e veçmas në Mirditë dhe në pjesë të tjera të Veriut të Shqipërisë, ku edhe ka hasur në zbatimin e rregullave të Kanunit, vjen në përfundim se thëniet e kanunit, përkatësisht të hartuesit të tij, Lekë Dukagjinit, të këtij *ligjvënësi antik* (siç e quan ajo) të malësorëve të Mirditës dhe të mbarë fiseve të tyre të veriut (duke përfshirë edhe pjesët e okupuara padrejtësisht nga Jugosllavia, për të cilat autorja e thotë bukur se “iu trupëzuan padrejtësisht Jugosllavisë”, janë të shenjta, ashtu sikurse edhe vetë Bibla e Shenjtë (Hasluck, 1954). Autorja mendimin e saj e bazon duke e mbështetur edhe në hulumtime dhe studime pararendëse, se “Sipas traditës ishte ai (pra Lekë Dukagjini, plotësimi im-B. M.) që hartoi ligjet që rregullojnë ende jetën e malësorëve” (Hasluck, 1954).

Sipas Hasluckut, Lekë Dukagjini, ashtu si Solloni i Athinës, mund t’i ketë rishikuar dhe kodifikuar ligjet ekzistuese, me sa duket, pa i shkruar në letër. Ajo beson se një numër i madh i neneve të kodit të Lekës janë të ngjashme me kodet romake dhe të popujve të tjerë antikë. Ajo beson në atë se ky kod është ruajtur më së miri në Mirditë, vend në të cilin studiuesi i shquar françeskan At Shtjefën Gjeçovi i mbledhi nenet e tij rreth vitit 1913. Libri i M. Hasluckut paraqet një kontribut të rëndësishëm të saj, e cila me Shqipërinë dhe shqiptarët, jo vetëm të pjesës veriore, ishte mishëruar dhe dëshironte të linte një kontribut në shkrimin e historisë së tyre në gjuhën angleze. Për kohën kur u shkrua kjo paraqet një aspekt me vlerë për etnografinë, por edhe për historinë shqiptare, aq sa ka mundur të trajtohej apo të kapej nga autorja.

5. Kazuhiko Yamamoto dhe struktura etike e Kanunit

Pesha dhe rëndësia e Kanunit të Lekë Dukagjinit ka zgjuar interesimin edhe te studiuesi japonez, Kazuhiko Yamamoto. Në nëntor të vitit 1991, Akademiku Yamamoto (Prof. dr. i cili aktualisht jep mësim në Universitetin e Kiushus në Japoni-plotësimi im, B.M) bashkë me gruan dhe djalin, udhëtonte nga qyteti ku jetonte, Fukuota, për në Tokio, ndërsa gjatë këtij udhëtimi ai kishte zgjedhur të lexonte romanin “Prilli i thyer” të shkrimtarit shqiptar, Ismail Kadare, të botuar në SHBA. Historia e këtij leximi, e cila do t’ia ndryshonte rrjedhën e mendimeve dhe madje edhe profesionin, kishte nisur një vit më parë më 1990, kur profesori ndodhej në Evropën Lindore.

Te romani i Kadaresë ajo që gjeti dhe që e mahniti ishin rregullat e Kanunit të shqiptarëve, mbi të cilat rregulla, siç e thotë edhe ai, ndërtohet fabula e romanit të Ismail Kadaresë. “Kur e lexova atë libër, u impresionova. Aty e kanë fillesën hulumtimet e mia mbi Kanunin dhe kulturën shqiptare” (Sinanaj, 2012), thotë studiuesi japonez Yamamoto, të cilit fillimisht iu desh të analizonte strukturën etike të Kanunit, duke e krahasuar atë me kulturën antike japoneze, të cilën do ta botonte në artikullin me titull “*Struktura etike e Kanunit: A përbën ai formën fillestare të etikës së shoqërisë shqiptare?* (Ethical structure in Kanun: THE ETHICAL STRUCTURE OF THE KANUN: IS IT THE ORIGINAL FORM OF ETHICS IN HUMAN SOCIETY?) Me këtë artikull, Kazuhiko Yamamoto pohon se deshi të elaboronte pikëpamjen e tij se *struktura etike e Kanunit përbënte formën fillestare të etikës që ka pasur njerëzimi*. Sipas tij, historia njerëzore në këto 2000 vjetët e fundit është histori e përballjes midis strukturës së Kanunit dhe forcave që përpiqen të mos e pranojnë atë.

Ndërkaq, hapi tjetër i kërkimeve të tij ishte sqarimi i problemit të nacionalizmit etik, sidomos i ultranacionalizmit japonez. Sigurisht që mjeti orientues i kërkimit ishte struktura etike e Kanunit dhe e logjikës së *Mishimas* që i dha mundësinë më pas të shkruante artikullin e dytë, të titulluar “*Studimi mbi konceptet etike të shkrimtarit ultranacionalist japonez Yukito Mishima*”.

“Në të unë desha të tregoja se struktura etike e Kanunit përfaqësonte një prej sistemeve logjike të përherëshme të ekzistencës njerëzore. M’u desh që të gjeja dëshmi për hipotezën time, se struktura etike e Kanunit vërtet ishte forma origjinale e etikës së shoqërisë njerëzore”. Kështu do të pohonte më vonë profesor Kazuhiko Yamamoto, kur, si rezultat i punës dhe i hulumtimeve të tij në këtë fushë, siç u tha edhe më lart, do të lindte mikroteza me titull: *The ethical structure of dhe kanun: Is it dhe original form of ethics in human society?* Apo në shqip: *Struktura etike e kanunit: A është ai forma origjinale e etikës në shoqërinë njerëzore?*, kurse pas një pune këmbëngulëse në këtë fushë, edhe libri tjetër më i thelluar e më i kompletuar "Struktura Etike e Kanunit dhe Nënkuptimet e saj Kulturore" (Yamamoto, 2005). I pari (mikroteza) u botua në Shqipëri, më 2001, nën përkthimin dhe përkujdesjen e Romeo Gurakuqit, ndërsa i dyti në vitin 2005 në Nju Jork, nën përkujdesjen e profesorit tash të ndjerë, Selaudin Velajt.

6. Struktura etike e Kanunit dhe konceptet etike të veprave homerike

Në studimin e tij krahasues, profesori dhe studiuesi japonez Kazuhiko Yamamoto përqendrohen tek aspekte etike të Kanunit, në kërkim të gjetjes së elementeve etike, por edhe duke i krahasuar ato me traditat antike japoneze. Sipas tij “tradita kryesore e Japonisë antike ishte koncepti i Mikut – Perëndi”. Ai sqaron mirë se “kur një i panjohur vizitonte një shtëpi, ai duhej të pranohej si një lloj Perëndie, një lajmëtar i Zotit”. Ndërkaq, gjatë studimeve të tij për Kanunin, ai do të gjejë ngjashmëri midis konceptit të mikut tek Kanuni dhe atij në kulturën antike japoneze.

Gjithashtu, gjatë hulumtimeve të tij, ai gjurmon edhe mbi konceptet etike të veprave homerike Iliada dhe Odisea, në të cilat, siç thotë ai, zbulon apo konstaton se gjashtë elementet e sipërpërmendura në Kanunin shqiptar ndodheshin edhe në to. Pra, ai vëren se elementet etike të veprave homerike ishin të njëjta me ato të Kanunit, gjë që është tepër e rëndësishme dhe madje e pathënë më parë. Ai analizon edhe tragjeditë greke, si ato të Eskilit dhe Sofokliut, në të cilat po ashtu gjen këto gjashtë koncepte. Sipas tij, në tragjedinë greke, disa elemente ndryshojnë, pasi që ato ishin shkruar në Athinë, e cila ishte një polis, pra një formë shteti. Ai është i mendimit se tragjeditë e Eskilit dhe Sofokliut pasqyrojnë kohët e ndërmjetme të moralit njerëzor: *nga ato të një shoqërie pa praninë e fuqisë së një shteti, në kohët e një shoqërie ku fuqia e shtetit është e pranishme*.

Struktura etike e Kanunit atij i dha rast të zbulonte se shoqëria homerike kishte një logjikë të ngjashme me strukturën etike të Kanunit, ku si përfundim, iu desh të shkruante përmbledhjen e kërkimeve të tij, në artikullin "Struktura etike e shoqërisë homerike". Sipas tij, natyrshëm më pas analiza e shoqërisë homerike u pasua me hulumtimin e tragjedisë greke. "Nuk ishte e zorshme për të zbuluar se tragjedia greke, e shkruar në shekullin e pestë para erës së re, e tradhtonte tragjedinë e epokës së artë antike greke, ku shpaloseshin përplasjet midis logjikës së shoqërisë pa autoritet shtetëror dhe logjikës së qytetit shtet". Dhe, për të arritur në këto përfundime, atij i janë dashur vizita të shpeshta në Veri të Shqipërisë. Ai është i bindur se shqiptarët e kanë konceptin e mikut dhe traditën e mikpritjes të njëjtë po me atë të japonezëve të lashtë.

Krahasimi i kulturës dhe traditës mes shqiptarëve dhe japonezëve të lashtë, studiuesin e shpie te koncepti i bukës (ushqimit), i cili është element i domosdoshëm për të kuptuar Kanunin. Kështu, te Kanuni, ai arrin të gjejë apo të evidentojë shtatë koncepte etike: *betimin, besën, nderin, mikun (mysafiri perëndi), bukën dhe hakmarrjen*.

7. Etika e shoqërisë pa pushtet shtetëror dhe Kanuni si sistem i vlerave të së ardhmes së qenieve njerëzore

Me gjithë vështirësitë që i dalin, Yamamoto në kumtesën e tij është përpjekur të gjente fillesën e etikës dhe rendit shoqëror në një shoqëri pa pushtet shtetëror. Krahassimi i strukturës etike të Kanunit me atë të një shoqërie pagane pa pushtet shtetëror dhe analizat kritike të teorive të *Hobbes*, *Rousseau*, *Nietzsche* dhe *Girard*, e shpjen te propozimi i një teorie të re, e cila ngulmon në idenë se një shoqëri pa pushtet shtetëror ka etikë dhe rend shoqëror që zhvillohen në mënyrë të vetvetishme në bazë të besimeve fetare pagane.

Meqenëse njerëzit në këtë bashkësi i referohen asaj si një forcë e shenjtë e dhënë prej zotërve, ai është i mendimit se hakmarrja e ndjekur nga pala e ofenduar është sanksioni më i fundit për të rivendosur dhe mbajtur rendin shoqëror në një shoqëri pa pushtet shtetëror. Në trajtesën e tij profesori japonez sugjeron se etika e shoqërive pa pushtet shtetëror, si për shembull shoqëria e lashtë, shoqëria primitive dhe shoqëria fisnore, kanë të njëjtën strukturë si ajo e Kanunit dhe konsiston në "Besën", "Gjakun", "Nderin", "Mikun", "Ushqimin" dhe "Hakmarrjen".

Meqenëse këto koncepte janë të lidhura me ndijimet trupore, emocionet dhe zakonet primitive, të cilat përfaqësojnë natyrën e qenieve njerëzore, ai konstaton se etika e një shoqërie pa pushtet shtetëror është më e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e qenieve njerëzore, sesa me atë të një shoqërie me pushtet shtetëror, e cila nuk e pranon hakmarrjen e ndërmarrë nga pala e ofenduar si një sanksion të drejtë. Sipas tij, "një shoqëri pa pushtet shtetëror nuk është një shoqëri arkaike që po zhduket më shpejtësi nga sipërfaqja e Tokës, por një shoqëri me një sistem vlerash të përcaktuara dhe vetëpërzetuese, e cila është thelbësisht e njëvlershme, po ashtu edhe *antitetike* me atë të një shoqërie me pushtet shtetëror".

Ai është i mendimit se ndryshimet kulturore në mes të kombeve, grupeve etnike ose grupeve të ndryshme njerëzore, si dhe identiteteve rezultante të këtyre grupeve që formohen transversalisht përtej sistemeve të farefnisnë, janë baza mbi të cilën ngrihet një shoqëri me pushtet shtetëror. Konstatimi i tij është: "Në qoftë se njerëzit në një shoqëri me pushtet shtetëror humbasin ndryshimet kulturore dhe identitetin, gjë që u bën atyre të mundur të ndërtojnë marrëdhënie përtej sistemeve farefnisnore, themeli i funksionimit të pushtetit shtetëror bëhet i dobët dhe i paqëndrueshëm."

Ai konstaton se globalizimi dhe homogjenizimi i botës mund t'u shkaktojë në mënyrë ironike qenieve njerëzore humbjen e bazamentit të një shoqërie me pushtet shtetëror, e cila përfundimisht rezulton në ardhjen e një tipi të ri shoqërie ku sistemi i vlerave të një shoqërie pa pushtet shtetëror mund të jetë mbizotërues. Prandaj, përfundimisht ai mendon se *etika e një shoqërie pa pushtet shtetëror, e përfaqësuar prej Kanunit, nuk është një sistem i vlerave të së kaluarës, por një sistem vlerash që do të bëhet fakt në të ardhmen e qenieve njerëzore.*

8. Përfundimi

Siç shihet, përpjekjet e studiuesve të huaj në studimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit nuk kanë reshtur asnjëherë, ndërkaq ato u intensifikuan pas Luftës së Dytë Botërore dhe veçmas në dekadat e fundit të shekullit të kaluar (XX). Në interesimit dhe studimet e tyre ata fokusohen në aspekte relevante të kësaj vepre monumentale të etnokulturës shqiptare. Kjo u vërejt edhe në veprat që patëm në shqyrtim të Edith Durhamit, Margaret Hasluckut dhe Kazuhiko Yamamotos. Te E. Durhami pamë se Kanuni i Lekë Dukagjinit i ngjan shumë ligjit të fisit të vendeve të tjera. Autorja, jo rrallë hedh dyshimin nëse ai është krijuar në shekullin e pesëmbëdhjetë.

Jo pa të drejtë, ajo mendon se mund të jetë shumë më i hershëm sesa pretendohet, ndërsa Lekë Dukagjini, si kodifikues i mundshëm, sipas saj na del më tepër si rikodifikues që në mungesë të ligjeve dhe shtetit, përmes ndryshimeve u përpoq të ndalonte krimet e shumta të asaj kohe dhe përmes akteve të futura të sanksiononte dënime të caktuara që mund të shpinin në ndalimin e së keqes së madhe të popullit të tij. Ndërkaq, Margaret Hasluck (Margaret Hezllak) me anë të librit të saj “Ligji i pashkruar në Shqipëri”, që për fat të keq nuk u përfundua në kohën kur ajo ishte gjallë, jep një kontribut të rëndësishëm për etnografinë shqiptare të shkruar në gjuhën angleze në pjesën e parë të shekullit XX. Autorja të drejtën zakonore shqiptare e sheh si mjet i kuptimit të bazave themelore logjike të këtij kodi si dhe zbatimin e tij në praktikë.

Profesori dhe studiuesi japonez Kazuhiko Yamamoto, në studimin e tij krahasues “Struktura etike e kanunit”, fokusohet tek aspektet etike të Kanunit, gjithnjë në kërkim të gjetjes së elementeve etike dhe të krahasimit të tyre me traditat antike japoneze. Në këtë kontekst, ai gjen edhe shumë ngjashmëri midis konceptit të mikut te Kanuni dhe atij në kulturën antike japoneze etj. Me një fjalë, përpjekjet e studiuesve të huaj, në të gjitha kohët, janë përpjekje të rëndësishme, kontribute të pamohueshme dhe të vazhdueshme në ndriçimin e shumë aspekteve që kanë të bëjnë jo vetëm me të drejtën zakonore shqiptare, por edhe për aspekte relevante që përkojnë me lashtësinë tonë shtetformuese.

Referencat

- [1]. Shtjefën K. Gjeçov O.F.M: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Botime Françeskane, Shkodër, 1933.
- [2]. Shtjefën K. Gjeçov O.F.M: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shtëpia Botuese “Kuvendi”, Shkodër, 1999.
- [3]. “*Kanuni i Lekë Dukagjinit - mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi*” me biografi dhe parathënie të Prof. dr. Syrja Pupovcit, ETMM të KSAK-ut, Prishtinë, 1972.
- [4]. Akademia e Shkencave e RPSSH-së, *E drejta zakonore shqiptare (Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K. Gjeçovi)*, Tiranë, 1989.
- [5]. At Shtjefën K. Gjeçov, *Kanuni i Lekë Dukagjinit, botim i dytë, me himje, shtesa e plotsime prej At Benediktit Dema O.F.M., kodifikue nga Dr. Emid Tedschini adv*, Botime Françeskane, Shkodër, 2018.
- [6]. Edith Durham, *Some Tribal Origins, Laws and Customs of the Balkans*, 1928.
- [7]. Edith Durham, *Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve*, Argeta – LGM, Tiranë, 2019.
- [8]. Kazuhiko Yamamoto, *Struktura etike e Kanunit dhe nënkuptimet e saj kulturore*, New York, Kopertina dhe faqosja Melosi Design, 2005.
- [9]. Kazuhiko Yamamoto, *Struktura etike e së drejtës zakonore shqiptare* (The ethical structure of the albanian customary law), shqipëroi: Selahedin Velaj, botoi: West Print, 2015. F. 418.
Tonin Çobani, *Gjergj Fishta dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Botimet Fishta, 2014.
- [10]. Franc Nopça, *Fiset e Malësisë së Shqipërisë Veriore dhe e Drejta Zakonore e tyre*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botimet Eneas, Tiranë, 2013.
- [11]. Hasluck, Margaret Masson Hardie, 1885-1948 “The unwritten law in Albania”. 1. Customary law-Albania. 2. Albania-Social conditions Cambridge: University Press, 1954.
- [12]. Margaret Hasluck, *Ligji i pashkruar shqiptar (Kanuni shqiptar)* “The unwritten law in Albania”(1954), përkth. Leka Ndoja, Lisitan, Tiranë, 2005.
- [13]. Jur Johan Georg von Hahn, *Studime shqiptare (Albanesische studien*, Jena, 1854), “Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2007.
- [14]. Besim Muhadri, *Shtjefën Gjeçovi dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, Gjakovë, 2020.